



**Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, takohet me përfaqësues të Bankës Botërore dhe të FMN-së**

Vijon në faqen 2

**Ndryshimi i tarifave të sigurimit të detyrueshëm MTPL dhe funksionimi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit - në qendër të diskutimeve në takimin e Kryetares së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi me drejtorët e shoqërive të sigurimit**

Vijon në faqen 2

**VËSHTRIM MBI TREGJET**

*Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon Gjeografinë e Sigurimeve 2011*

Vijon në faqen 3

*Tregu i sigurimeve për periudhën janar-gusht 2012*  
*Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-gusht 2012 arritën shifrën 5,842,458 mijë lekë.*

Vijon në faqen 4

*Tregu i Pensioneve Private Vullnetare për periudhën janar-qershor 2012*

Vijon në faqen 6

*Asete në rritje nga veprimtaria e Fondeve të Pensioneve Private Vullnetare.*

Vijon në faqen 6

**ZHVILLIME TË TJERA**

*“Përcaktimi i standardeve dhe identifikimi i praktikave më të mira që rregullojnë tregun e sigurimeve” – Takimi vjetor i Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimeve (NAIC) në SHBA, (11-14 gusht 2012)*

Vijon në faqen 6

*Menaxhimi makroekonomik dhe stabiliteti financiar - në qendër të vëmendjes së zyrtarëve të lartë të financave Slloveni (3-4 shtator 2012)*

Vijon në faqen 7

*Mbi shkëmbimin e informacionit, standardet ndërkombëtare dhe reformën financiare në fushën e letrave me vlerë-takim rajonal i drejtuesve të lartë financiarë*

*Ukraine (10-14 shtator 2012)*

Vijon në faqen 8

*AMF pjesëmarrëse në përcaktimin e planit të masave për Shqipërinë në çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*

*Paris (20 shtator 2012)*

Vijon në faqen 9

*Influenca e mbikëqyrjes me fokus riskun mbi shoqëritë e sigurimit dhe ndikimin pozitiv që ajo ka në mbrojtjen e interesave të të siguruarve.*

*Tiranë (17-21 shtator 2012)*

Vijon në faqen 10

*“Struktura e vlerësimit të riskut, mbikëqyrja e sigurimeve me bazë risku dhe perspektiva” në qendër të seminarit rajonal.*

*Poloni (24-26 shtator 2012)*

Vijon në faqen 10

*Zhvillohet Forumi i parë i Rregullatorëve të Tregjeve të Kapitalit nga Bordi i Tregjeve të Kapitalit të Turqisë, Stamboll (26-27 shtator 2012)*

Vijon në faqen 12

*Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse për fondet e pensionit dhe ndërtimi i kapaciteteve për çështje të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në vëmendjen e takimit të radhës së Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s*

*Paris (25 shtator 2012)*

Vijon në faqen 12

*Trajnimi i mëtejshëm për aktuarët shqiptarë me metodikat dhe eksperiencat më të mira në Mbretërinë e Bashkuar (22-29 shtator 2012)*

Vijon në faqen 14

**TË REJA NGA RAJONI**

*Të dhënat për gjashtëmuorin e parë, 2012*

**BULLGARI**

Vijon në faqen 15

**SLLOVENI**

Vijon në faqen 16

**MAQEDONI**

Vijon në faqen 16

## **KRYETARJA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, ZNJ. ENKELEDA SHEHI, TAKOHET ME PËRFAQËSUES TË BANKËS BOTËRORE DHE TË FMN-SË**

Në datat 25 dhe 26 shtator 2012, Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkelelda Shehi, zhvilloi takime pune me përfaqësues të Bankës Botërore dhe të FMN-së.

Në të dy takimet interesi i ekspertëve ishte kryesisht tek ecuria e tregjeve që AMF mbikëqyr, si dhe zhvillimet më të fundit në kuadrin rregullator

për tregjet e sigurimeve, pensioneve private vullnetare e letrave me vlerë.

Takimet ishin të karakterit teknik, ku Kryetarja e Autoritetit Znj. Enkelelda Shehi dhe grupi i ekspertëve të AMF-së, bënë një panoramë të detajuar të situatës së tregjeve, projekteve dhe sfidave aktuale me të cilat AMF përballet në ushtrimin e funksionit rregullator.

## **KRYETARJA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, ZNJ. ENKELEDA SHEHI, TAKOHET ME DREJTORËT E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT MBI NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MTPL DHE FUNKSIONIMIN E BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT**

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkelelda Shehi, zhvilloi më datë 24 shtator 2012, një takim me drejtorët e shoqërive të sigurimit. Takimi kishte në fokus të tij dy problematika kryesore, ndryshimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm, MTPL dhe funksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, BSHS.

Duke reflektuar mbi situatën e tregut të sigurimeve në fillim të muajit shtator të këtij viti, Kryetarja e Autoritetit, tërhoqi vëmendjen e shoqërive për plotësimin e detyrimeve ligjore për raportimin brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” në lidhje me ndryshimet e tarifave të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve, MTPL. Kryetarja e Autoritetit e theksoi këtë kërkesë

në respekt të rritjes së transparencës dhe bashkëpunimit me shoqëritë, edhe pse sipas ligjit, tarifatat e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve, MTPL, janë të liberalizuara dhe shoqëritë e sigurimit kanë të drejtë t’i përcaktojnë vetë ato.

Gjithashtu, Kryetarja e Autoritetit u ndal edhe në problematikën e funksionimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe realizimin e detyrimit që shoqëritë e sigurimit kanë për Fondin e Kompensimit, si dhe pagesat e dëmeve që rrjedhin prej tij.

Në takim u vendos krijimi i një grupi pune, nën drejtimin e AMF-së, si dhe me juristë të propozuar edhe nga Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë për të bërë ndryshimet e nevojshme në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe rregulloret në zbatim të tij, me qëllim saktësimin e detyrimit të shoqërive

Takimi kishte në fokus të tij dy problematika kryesore, ndryshimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm, MTPL dhe funksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, BSHS.

të sigurimit dhe të drejtave të palëve të dëmtuara ose përfituese nga sigurimet e detyrueshme motorike, MTPL.

Në mbledhje u kërkua që shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS-së, të depozitojnë në Autoritet propozimin tjetër për rillogaritje të shtesës së

Fondit të Kompensimit për vitin 2012, bazuar në përlogaritjen e të gjithë faktorëve, me qëllim përshtatjen e këtij fondi. Megjithëse ka përmirësime të dukshme në pagesat e dëmeve, Kryetarja, tërhoqi vëmendjen për kujdes të shtuar në këtë drejtim, duke mos e vonuar procesin.

## VËSHTRIM MBI TREGJET

### Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon Gjeografinë e Sigurimeve 2011

Gjeografia e sigurimeve është një material përmbledhës që tregon informacion të detajuar mbi dendësinë e sigurimeve, shpërndarjen e primeve dhe produkteve të sigurimit sipas prefekturave.

Duke i hedhur një vështrim primit të shkruar bruto sipas shpërndarjes gjeografike, të bie në sy një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tiranë 60%, Durrës 7.89%, Fier 5.45%, Korçë 4.96%. Kjo tendencë përqendrimi ka vazhduar të jetë e njëjtë gjatë gjithë viteve të publikimit të raportit Gjeografia e Sigurimeve.

Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është dendësia e sigurimeve, i cili për vitin 2011 është rreth 2,937.18 lekë për frymë me një rritje prej 385.58 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura e Tiranës me 6,534.68 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga prefektura Gjirokastrë me 4,597.77 lekë për frymë dhe më tej Durrësi dhe Vlora përkatësisht me 2,473.42 lekë për frymë dhe 1,884.10 lekë për frymë.

Ky publikim përfshin gjithashtu edhe informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2011 sipas



Gjeografia e Sigurimeve 2011

prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë, ku përsëri pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e ka prefektura e Tiranës me 65.91% e pasuar nga prefektura Durrës me 9.23%.

Në brendësi të publikimit, informacioni i pasqyruar lejon mundësinë e analizave më të detajuara të tregut të sigurimeve, vlerësimin e përqendrimit të tregut, si edhe shpërndarjen e risqeve sipas prefekturave. Këtë publikim, të cilin Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e ka sjellë pranë lexuesit për herë të parë me të dhënat e vitit 2007, ka vazhduar ta përpunojë e pasurojë nga viti në vit.

Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është dendësia e sigurimeve, i cili për vitin 2011 është rreth 2,937.18 lekë për frymë me një rritje prej 385.58 lekë krahasuar me një vit më parë.




## Vështrim mbi tregun e sigurimeve për janar-shtator 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-shtator 2012 arritën shifrën 6,519,488 mijë lekë, përkundrajt 6,531,255 mijë lekë të realizuara në janar-shtator 2011 ose 0.18% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 49.98% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 50.02% të tregut. Përsa i takon tregut, në veçanti, kemi një rënie në masën

21.49% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje prej 3.02% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 90.31% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.62% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.07% nga veprimtaria e risigurimit.

Në janar-shtator 2012 u nënshkruan rreth 911,396 kontrata sigurimi, ose 8.29% më pak se në janar-shtator 2011.


### Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-shtator 2012



### Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-shtator

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2011	2012
<b>A) Sigurim i Jetës</b>	798,891	627,188
<b>B) Sigurim i Jo-Jetës</b>	5,715,247	5,887,991
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	3,009,328	3,261,235
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,705,918	2,626,757
<b>C) Risigurimi</b>	17,117	4,309
<b>TOTAL</b>	<b>6,531,255</b>	<b>6,519,488</b>

### Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-shtator 2012 (Jeta dhe Jo-Jeta)



### Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-shtator 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 3,261,235 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-shtator 2012, arritën 2,357,917 mijë lekë, ose 34.92% më shumë se janar-shtator 2011.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit, në periudhën janar-shtator 2012, arritën rreth 6,519 milionë lekë, ose 0.18% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në janar-shtator 2012, primet e shkruara bruto të Kartonit Jeshil ishin 480,165 mijë lekë, ose rreth 48.05% më pak se në janar-shtator 2011. Kjo ulje e primit shkruar bruto Karton Jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-shtator 2012 arritën në 423,153 mijë lekë, apo 25.40% më shumë se në janar-shtator 2011.

### Sigurimet vullnetare

Për janar-shtator 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,258,253 mijë lekë, ose 7.49% më pak se të ardhurat e janar-shtator 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 2,626,757 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe dëme të tjera në pronë me 43.48% të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 18.61%, dhe nga sigurimi kasko me 15.49%, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-shtator 2012, arritën në 488,969 mijë lekë, 31.06% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 60.87% të të ardhurave të këtij grupi.


Primet në sigurimet e jetës në janar-shtator 2012 arritën në 627,188 mijë lekë, ose 21.49% më pak se në janar-shtator 2011.

### Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: SIGAL UNIQA Group Austria, SIGMA Vienna Insurance Group, INSIG, ATLANTIK, INTERALBANIAN,

ALBSIG, INTERSIG Vienna Insurance Group EUROSIG dhe ANSIG. SIGAL UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 30.02% të primeve.

### Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-shtator 2012 (Jo-Jeta)



### Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-shtator 2012 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria, INSIG dhe SICRED. SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 51.48% të primeve.

### Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-shtator 2012 kapi vlerën 2,122,920 mijë lekë, ose 33.62% më shumë se në janar-shtator 2011. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,560,372 mijë lekë, apo 73.50% të totalit.

Primet nga sigurimet e Jetës gjatë periudhës janar-shtator 2012 arritën rreth 627 milionë lekë, ose rreth 21.49% më pak se janar-shtator i vitit të kaluar.

## Tregu i Pensioneve Private Vullnetare për periudhën janar-qershor 2012

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në 30.06.2012 tregon një total të aseteve neto nën menaxhim **211,577,818** lekë dhe me një rritje të këtyre aseteve neto nga veprimtaria e Fondeve të Pensioneve prej afro 4.8 milion lekë.

### Vlera e Aseteve Netë sipas Fondeve të Pensioneve, 30 qershor 2012


(në lekë)

Fond Pensioni	Asete Neto
SIGAL	97,697,624
RAIFFEISEN	91,835,856
SICRED PENSION	22,044,337
<b>TOTAL</b>	<b>211,577,818</b>

Numri i anëtarëve në Fondet e

Pensioneve private vullnetare më 30 qershor 2012 rezultoi në 6,534 anëtarë, me një rritje me 3.8% krahasuar me vitin 2011.

### Ndarja e Tregut sipas Numrit të Anëtarëve në Fondet e Pensioneve, 30 qershor 2012 (në %)



## ZHVILLIME TË TJERA

### Përcaktimi i standardeve dhe identifikimi i praktikave më të mira që rregullojnë tregun e sigurimeve

Tregu i sigurimeve ishte prekur më pak se në çdo krizë të kaluar me të cilat është përballur SHBA në të shkuarën.

Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve (NAIC) në SHBA zhvilloi në datat 11-14 gusht në Atlanta, SHBA, takimin periodik me objekt “Përcaktimin e standardeve dhe identifikimit të praktikave më të mira që rregullojnë tregun e sigurimeve”.

Në sesionin e ditës së parë të takimit u bë një përshkrim i shkurtër i periudhës së vështirë ekonomike që po kalonte SHBA dhe si kishte ndikuar kjo në tregun e sigurimeve. Tregu i sigurimeve ishte prekur më pak se në çdo krizë të kaluar me të cilat është përballur SHBA në të shkuarën.

Në këtë takim Kombëtar të NAIC ishin ngritur shtatë komitete Ekzekutive, të cilat do të diskutonin dhe miratonin raportet finale sipas tematikave përkatëse.

*Komiteti i Sigurimit të Shëndetit* miratoi raportet e hartuara nga grupet e punës që kishin lidhje me zbatimin e reformave të shëndetit sipas Aktit të Kujdesit Federal.

*Grupi i punës së Aktuarëve të Shëndetit* diskutoi në takimin e ditës së dytë:

- Formulën e rifinancimit të shtesës të kujdesit mjekësor;
- Problemet aktuariale që lidhen me reformën e kujdesit shëndetësor;
- Krijimin e një table të re vlerësimi për sigurimin e sëmundjes së kancerit, si dhe;
- Krijimin e një table të re vlerësimi për sigurimin e paaftësisë në punë për një periudhë afatgjatë.

*Grupi i punës i Kuadrit Rregullator Ligjor* rishikoi Aktet model të

propozuara nga NAIC, dispozitat e reformave të tregut në tërësi, si dhe vazhdoi diskutimet për rishikimin e mundshëm të Rregullores Model të Përfitimeve për të trajtuar çështje që lidhen me mbulimin e përfitimeve mjekësore në kontratat tip të mjeteve në vlerësimin e situatave “fajtor” dhe “jo fajtor”, si dhe shtimin e moshës së personit në ngarkim deri në 26 vjeç.

Në takimin e këtij grupi pune u shpërnda një draft buletin mbi raportimin financiar të shpenzimeve të përmirësimit të sistemit shëndetësor, të cilat deri më sot konsideroheshin si shpenzime administrative. Anëtarët e këtij grupi shpjeguan se shpenzimet e përmirësimit të sistemit shëndetësor janë shpenzimet e krijuara nga shoqëritë e sigurimit të shëndetit, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të kujdesit shëndetësor në tërësi. Pas diskutimeve në lidhje me kompetencat dhe standardet e NAIC në lidhje me këtë çështje, Grupi i Punës i Kuadrit Rregullator Ligjor miratoi këtë buletin.

*Komiteti i Mbrojtjes Konsumatore dhe Rregullimit të Tregut u njoh me:*

- Vrojtimin e bërë mbi rregulloren e Tregut të Sigurimeve Shtetërore;
- Raportin e grupit të punës për Mbrojtjen e Konsumatorit;
- Raportin e grupit të punës për

çështjet e Mashtrimeve;

- Raportin e grupit të punës që trajton Procedurat e Analizës së Tregut;
- Raportin e Grupit të punës për Përfitimet e Kufizuara Mjekësore.

*Komiteti i Akreditimit dhe Standardeve të Tregut Financiar:*

- Miratoi Kapitalin me Bazë Risku për Organizatat e Shëndetit sipas Standardeve të Akreditimit;
- Diskutoi rishikimet e bëra për Ligjin e Modelit të Risigurimit dhe Rregullores përkatëse të këtij ligji;
- Diskutoi komentet e marra mbi rishikimin e Aktit të Mbajtjes së Riskut.

*Komiteti i Vlerësimit të Situatës Financiare miratoi raportet mbi:*

- Procedurat dhe praktikat e kontabilitetit; Mjaftueshmërinë e kapitalit; Aftësinë paguese dhe administrimin; Çështjet e risigurimit; Inisiativën e modernizimit të aftësisë paguese, etj.

*Komiteti i Pensionit Vjetor dhe Sigurimit të Jetës* diskutoi draftin e udhëzuesit të ri për pensionin vjetor dhe vendosi që ky version duhet të ishte më i lexueshëm dhe kuptueshëm për konsumatorin pasi versioni i kaluar ishte shumë teknik dhe i gjatë.

## Menaxhimi makroekonomik dhe stabiliteti financiar

Qendra e Ekselencës Financiare (ECF) e Ministrisë së Financave, Slloveni, në bashkëpunim me Joint Vienna Institute (JVI) zhvilloi gjatë periudhës 3-7 shtator 2012, seminarin mbi politikën e rëndësishme makroekonomike dhe stabilitetin financiar.

Në këtë seminar merrnin pjesë zyrtarë

nga bankat qendrore, ministritë e financave dhe rregullatorë të tjerë të tregut financiar, të përfshirë në formulimin dhe zbatimin e politikave makroekonomike dhe politikave rregullatore financiare.

Objektivat kryesore të seminarit ishin trajtimi i politikave kryesore makroekonomike me të cilat përballen

Objektivat kryesore të seminarit ishin trajtimi i politikave kryesore makroekonomike me të cilat përballen autoritetet rregullatore në ekonominë në zhvillim dhe ato të zhvilluara.

autoritetet rregullatore në ekonomitë në zhvillim dhe ato të zhvilluara, si dhe alternativat e vlefshme të vendim-marrësve në këto vende, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve se si sektori financiar bashkëvepron me menaxhimin makroekonomik.

Seminari trajtoi në mënyrë të veçantë baza analitike të dhënash për të vlerësuar stabilitetin dhe rritjen makro-ekonomike dhe financiare, politikën fiskale dhe qëndrueshmërinë e borxhit publik, politikat monetare, rregullimin ligjor të sektorit financiar, si dhe sfidat e periudhës aktuale.

Ndër temat e trajtuara gjatë seminarit, përmendim:

- Përvojën nga krizat e mëparshme financiare;
- Politikat fiskale dhe qëndrueshmërinë e borxhit publik;
- Politikat monetare, si dhe;
- Stabilizimin dhe reformat makro-ekonomike.

Gjatë seminarit u trajtuan raste ushtrimore, me qëllim aftësimin për të analizuar situatën ekonomike dhe identifikuar rreziqet për qëndrueshmërinë financiare.

## **Seminar rajonal i drejtuesve të lartë “Mbi shkëmbimin e informacionit, standardet ndërkombëtare dhe reformën financiare në fushën e letrave me vlerë”**

Me ftesë të Kryetarit të Komisionit të Letrave me vlerë dhe Bursës të Ukrainës, në datat 10-14 shtator 2012, në Kiev të Ukrainës, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Enkeleda Shehi dhe një nga përfaqësuesit e lartë të AMF-së morën pjesë në seminarin rajonal “Mbi shkëmbimin e informacionit, standardet ndërkombëtare dhe reformën financiare në fushën e letrave me vlerë”.

Seminari u organizua në bashkëpunim me Toronto Center dhe me mbështetjen e misionit të USAID të Ukrainës, Moldavisë dhe Bjellorusisë. Fokusi i seminarit ishte forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit mes rregullatorëve në kuadrin e organizatës së IOSCO-s, shkëmbimi i eksperiencës në çështjet që lidhen me qeverisjen e shoqërive dhe mbrojtjen e investitorëve, si dhe nxjerrja e mësimave nga studimi i disa rasteve mbi praktikën e paligjshme të tregtimit të letrave me vlerë.

Gjithashtu, seminari i kushtoi vëmendje edhe sjelljes së rregullatorëve në rastin e krizës financiare, nëpërmjet stimulimit të një rasti hipotetik, duke synuar t’u ofronte pjesëmarrësve zgjidhjet e mundshme për t’iu përgjigjur ngjarjeve të tilla si kriza financiare.

Gjatë ditëve të seminarit, drejtues të lartë të 13 autoriteteve rregullatore nga vende të ndryshme të Evropës Lindore, Juglindore dhe të ish republikave sovjetike diskutuan dhe shkëmbyen eksperiencën e tyre në fushën e letrave me vlerë, nën drejtimin e lektorëve me kualifikim të lartë dhe eksperiencë të gjatë drejtuese.

Në kuadrin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës, Kryetarja e AMF-së, znj. Enkeleda Shehi zhvilloi takime të veçanta pune me Z. Dmytro Teveliev, Kryetar i Komisionit të Letrave me vlerë dhe Bursës së Ukrainës, si dhe me Z. Zoran Cirovic, kryetar i Komisionit të Letrave me vlerë të Serbisë. Znj. Shehi, gjithashtu, u takua edhe me përfaqësues të

Seminari i kushtoi vëmendje edhe sjelljes së rregullatorëve në rastin e krizës financiare, nëpërmjet stimulimit të një rasti hipotetik, duke synuar t’u ofronte pjesëmarrësve zgjidhjet e mundshme për t’iu përgjigjur ngjarjeve të tilla si kriza financiare.



lantë të autoriteteve rregullatore, pjesëmarrës në seminar. Shkëmbimi i informacioneve të përbashkëta në rajon dhe përvojave më pozitive është

vlerësuar si një mundësi e mirë në zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve dhe në rritjen efikasitetit të punës së autoriteteve rregullatore.

## Realizimi i planit të masave të marra nga Republika e Shqipërisë për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në kuadër të raportimit të delegacionit shqiptar në FTAF (Financial Action Task Force), në 20 shtator 2012, në Paris, Francë u zhvillua takimi i radhës në lidhje me realizimin e planit të masave të marra nga Republika e Shqipërisë për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Delegacioni shqiptar kryesohej nga Zv/Ministrja e Drejtësisë znj. Brikena Kasmi. Pjesë e këtij delegacioni ishte edhe përfaqësuesja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike për çështjet që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare, si dhe përfaqësues nga

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Në kuadër të monitorimit të rekomandimeve të dhëna nga Komiteti MONEYVAL, të Këshillit të Evropës (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit) organizohen periodikisht takime ku institucionet shqiptare, të përfshira në këtë proces, pra edhe AMF, raportojnë për masat e marra dhe shkallen e përbushjes së rekomandimeve të dhëna.

Gjatë takimit AMF raportoi për masat e marra në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ato që do të merren në të ardhmen.

Raporti i vlerësimit të Komitetit MONEYVAL për AMF-në, vuri theksin në çështjet që lidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes nga ana e AMF-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

AMF u përfshi në procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL, të Këshillit të Evropës në lidhje me masat e marra në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, raundi i katërt, gjatë periudhës korrik 2010 - mars 2011.

AMF përgatiti për fushat nën juridiksionin e tij, përgjigjet e pyetësorit të hartuar nga ekspertët e Komitetit të MONEYVAL-it, pranë KE-së, pyetësor që do t'i shërbente raundit të katërt të vlerësimit të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Vlerësimi i mëparshëm ishte kryer nga ky komitet në vitin 2006. Më pas ky proces vazhdoi me vizitën në Shqipëri të grupit të ekspertëve të Komitetit MONEYVAL më 15 - 30 nëntor 2010.

Mbi bazën e përgjigjeve të pyetësorit, bazës juridike të vënë në dispozicion, si dhe informacionit të marrë gjatë takimeve të ekspertëve të Komitetit të MONEYVAL, u hartua raporti i vlerësimit të MONEYVAL-it për Shqipërinë, përfshirë edhe tregun financiar jo-bankar.

Raporti i vlerësimit të Komitetit MONEYVAL për AMF-në, vuri theksin në çështjet që lidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes nga ana e AMF-së në fushën e parandalimit të pastrimit të

parave dhe financimit të terrorizmit, me trajnimin e stafit të mbikëqyrjes edhe me çështjet e forcimit të bashkëpunimit institucional, si brenda vendit dhe në plan ndërkombëtar.

## Zhvillohet seminari: “Mbikëqyrja me fokus riskun”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF, me mbështetjen e USAID, nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri, FSVC, zhvilluan gjatë periudhës 17-21 shtator trajnimin “Mbikëqyrja me fokus riskun”. Pjesëmarrës në trajnim ishin specialistë të mbikëqyrjes pranë AMF-së, si dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit morën njohuri teorike dhe praktike për efektivitetin e mbikëqyrjes me fokus riskun, mënyrën se si i influencon ajo shoqëritë e sigurimit dhe ndikimin pozitiv që kjo mënyrë mbikëqyrjeje ka në mbrojtjen e interesave të të

siguruarve pranë këtyre shoqërive.

Trajneri i këtij William D. Cundiff, konsulent i certifikuar në sigurime, me eksperiencë mbi 30 vjeçare në tregun e sigurimeve, si dhe trajner në kurse të ngjashme që prej 2005 në mjaft institute në Londër, trajtoi temat e poshtëshënuara:

- Mbledhja e informacionit dhe analiza paraprake;
- Inspektimi;
- Matrica e riskut dhe vlerësimi i tij;
- Vendosja e prioriteteve;
- Vlerësimi i sinjaleve të hershme dhe i situatave me risk të lartë.

## Struktura e vlerësimit të riskut, mbikëqyrja e sigurimeve me bazë risku dhe perspektiva

Nisma e Trajnimit për Mbikëqyrjen Financiare (TIFS), zhvilloi në Varshavë, Poloni, gjatë periudhës 24-26 shtator, seminarin për strukturën e vlerësimit të riskut, mbikëqyrja e sigurimeve me bazë risku dhe perspektiva. Seminari u organizua në formë prezantimi dhe shkëmbimi të eksperiencave dhe të dhënave nga vende të ndryshme, si Polonia, Gjermania, Shqipëria, Kosova, Moldavia, Kroacia, Lituania dhe Armenia për sa i përket procesit të Solvency II dhe menaxhimit të riskut.

Gjatë seminarit u prezantua procesi i rishikimit të mbikëqyrjes dhe struktura e vlerësimit të riskut në regjimin Solvency II. Pjesëmarrësit në seminar

ishin nga vende të ndryshme të botës, nëpunës të bankave qendrore, ministrive të financave, si dhe autoriteteve rregullatore.

Projekti i Solvency II, i cili do të zëvendësojë kërkesat aktuale për aftësinë paguese, prezanton mbikëqyrjen e bazuar në risk, me të cilat aktualisht përballet ose mund të përballet sigurimi e risigurimi në aktivitetin e tyre. Kjo është një nga sfidat kryesore jo vetëm për kompanitë e sigurimeve, por edhe për autoritetet mbikëqyrëse. Për mbikëqyrësit, një nga elementet kyçe të reja të mbikëqyrjes së bazuar në risk është procesi i rishikimit mbikëqyrës (SRP), së bashku me inspektimet në vend.

Gjatë seminarit u prezantua procesi i rishikimit të mbikëqyrjes dhe struktura e vlerësimit të riskut në regjimin Solvency II

Gjatë kryerjes së procesit të rishikimit mbikëqyrës, autoriteti mbikëqyrës duhet vazhdimisht të verifikojnë përputhjen me rishikimin e ligjit dhe të vlerësojnë strategjitë, proceset dhe procedurat e raportimit në mënyrë që të përputhen me Solvency II. Gjithashtu duhet të vlerësojë risqet të cilat përballen ose mund të përballen shoqëritë.

Qëllimi kryesor i Strukturës së Vlerësimit të Riskut (RAF) është promovimi i mbikëqyrjes me bazë rishikim duke identifikuar mbajtësit e riskut për shqyrtimin mbikëqyrës. Gjatë RAF autoriteti mbikëqyrës duhet të vlerësojë informacionin e brendshëm për të përcaktuar klasifikimin e riskut dhe ndikimin tek shoqëria. Duke marrë parasysh rezultatin RAF, autoriteti mbikëqyrës duhet të përcaktojë planin mbikëqyrës. Edhe pse regjimi Solvency II do të hyjë në fuqi në vitin 2014, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (KNF) është tashmë në lëvizje hap pas hapi drejt mbikëqyrjes me bazë rishikim. Ky proces kërkon detyra të reja që do të merren nga ana e mbikëqyrësve në mënyrë që të përgatiten për të identifikuar siç duhet, të vlerësojnë dhe të monitorojnë riskun në të cilën shoqëritë janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe për të vlerësuar sistemin e menaxhimit të riskut në çdo shoqëri të mbikëqyrur.

Gjatë seminarit u paraqitën metodologjitë e zhvilluara nga ana e Polonisë, në mënyrë që të përgatiten për zbatimin e kërkesave të ardhshme të RAF-it. Çështjet që u sollën gjatë ketyre prezantimeve, ishin shembuj praktikë dhe studime rasti të bazuara në përvojën e KNF-së dhe standardet në lidhje me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e risqeve. Gjithashtu morën pjesë dhe lektorë nga kompanitë e sigurimeve polake dhe firmave të auditimit.

Në veçanti, seminari trajtoi çështjet lidhur me:

- Rolin dhe funksionimin e procesit të rishikimit mbikëqyrës (SRP) dhe vlerësimi i riskut (RAF) në regjimin e Solvency II;
- Qëllimet dhe supozimet polake për RAF-it, procesi i vlerësimit vjetor dhe metodologjinë e tij;
- Vlerësimi sasior dhe cilësor (Strategjia, Struktura organizative, Portofoli, Marrëdhëniet me klientët, Transferimet, Sistemet e TI, Raportimi, Lidhja me Autoritet Mbikëqyrës, Auditimi i brendshëm / Vazhdimësia e biznes planit, Risigurimit, Menaxhimi i Aktiveve, Përgatitjet per Solvency II);
- Kërkesat për anëtarët e bordeve drejtuese dhe bordeve mbikëqyrëse të shoqërive të sigurimit;
- Qeverisja e korporatave dhe mbikëqyrja e pronarit, së bashku me identifikimin dhe vlerësimin e mekanizmave të ndryshëm të mbikëqyrjes pronarit;
- Risku i vet dhe vlerësimi i aftësisë paguese;
- Përgatitja e shoqërive të sigurimit drejt kërkesave të Solvency II dhe si autoritet e vlerësojnë këtë zhvillim;
- Ndryshimet e vlerësimit cilësor;
- Përzgjedhja e aktiviteteve mbikëqyrëse;
- Verifikimi, analizimi dhe vlerësimi i informacionit të prezantuar në pyetësorët e RAF-it nga ana e kompanive të sigurimeve nga perspektiva e inspektimit në terren.

Qëllimi i seminarit ishte krijimi i një forumi diskutimi që ofronte mundësinë për mbikëqyrësit nga vendet evropiane për të ndarë përvojën dhe zhvillimin e kuadrit mbikëqyrës, si dhe të paraqiste metodologjinë e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) në lidhje me Solvency

---

Qëllimi i seminarit ishte krijimi i një forumi diskutimi që ofronte mundësinë për mbikëqyrësit nga vendet evropiane për të ndarë përvojën dhe zhvillimin e kuadrit mbikëqyrës, si dhe të paraqiste metodologjinë e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) në lidhje me Solvency II

---

II. Çështjet e diskutuara në seminar janë të bazuara në përvoja praktike në

zbatimin e standardeve mbikëqyrës në tregun e sigurimeve.

## Zhvillohet Forumi i parë i Rregullatorëve të Tregjeve të Kapitalit

Bordi i Tregjeve të Kapitalit të Turqisë, zhvilloi gjatë periudhës 26-27 shtator 2012, në Stamboll Turqi, Forumin e parë të Rregullatorëve të Tregjeve të Kapitalit.

Ky Forum është ngritur për të drejtuar bashkëpunimin financiar midis vendeve të Komitetit për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar të Organizatës së bashkëpunimit islamik (COMCEC) të vendeve pjesëmarrëse. Qëllimi i këtij Forumi ishte të nxisë përdorimin e standardeve rregullatore ndërkombëtare dhe zhvillimin e mundësive rregullatore në përmbushjen e objektivave për mbrojtjen e investitorëve, për tregje sa më efçente dhe për reduktimin e riskut.

Një nga objektivat e Forumit ishte harmonizimi më i mirë i politikave nëpërmjet programeve për asistencë teknike dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Për realizimin e këtyre objektivave u diskutua në lidhje me:

- Zhvillimin e tregut;
- Ndërtimin e kapaciteteve;

- Financat islamike;
- Shkëmbimin e njohurive në fushën financiare.

Në forum u vu theksi se si ekonomia botërore i është nënshtruar ndryshimeve të dukshme këto dekadat e fundit, si nga ana ekonomike ashtu edhe financiare. Aplikimi dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare është bërë gjithmonë e më i rëndësishëm për të gjitha ekonomitë dhe kërkon ndërtimin e kapaciteteve për institucionet e tregjeve të kapitaleve publike dhe private. Në këtë perspektivë, qëllimi kryesor qëndron në diskutimin e bashkëpunimeve të reja dhe fushat e koordinimit, për forcimin e rregullatorëve të tregut kapital në mënyrë që tregjet financiare të veprojnë në interesin më të mirë të investitorëve dhe pjesëmarrësve të tregjeve.

Që prej krizës globale financiare, shkëmbimi i njohurive financiare është bërë një element i rëndësishëm për stabilitetin financiar dhe për zhvillimin ekonomik. Për këtë arsye, në këtë forum, u vu theksi te përmirësimi i shkëmbimeve të praktikave më të mira midis rregullatorëve të vendeve anëtare.

## IOSCO zhvillon takimin e radhës të Komitetit Rajonal Evropian

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), zhvilloi takimin e radhës së Komitetit Rajonal Evropian më

25 shtator 2012, në Paris, Francë. Në takim u diskutua që si rrjedhojë e krizës financiare botërore, pritshmëritë janë që tregu i titujve të



luajë një rol shumë më të madh sesa deri më sot për financimin e ekonomisë në tërësi. Nisur nga kjo pritshmëri është strategjike që IOSCO të luajë një rol edhe më të madh në çështjet e tregjeve të kapitalit dhe të rrisë peshën e vet në raport me organizma të tjerë: ECB, FSB, G20, BIS BASLE, etj.

Në këtë kuadër, një pjesë të rëndësishme zunë temat që priten të diskutohen në takimin e Bordit në Madrid. Për herë të parë në këtë takim do të ftohen edhe individë me profil të lartë nga sektori privat, me qëllim që të shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet kryesore që lidhen me tregun e titujve dhe çfarë mund të bëhet për to. Temat që priten të diskutohen janë:

- *Shadow banking*, me të cilën kuptohet çdo gjë që nuk është bankë, sidomos fondet e investimit në tregun e parave. Pikëpamja është që këto veprimtari duhet të mbikëqyren nga rregullatorët e titujve dhe është e rëndësishme që IOSCO të dalë me një qëndrim të tillë.
- *OTC derivatives*, për të cilat përsëri ngrihet problemi se cili do t'i mbikëqyrë dhe IO.
- *Benchmarking*, ku u diskutua ngritja e një grupi pune në nivel Bordi për Financial Market Benchmarking, gjë që lind si domosdoshmëri e problemeve që kanë dalë për këtë çështje (rasti më i fundit problemi me LIBOR).
- *Sanctioning regime*, për të cilin u theksua se IOSCO ka përgjegjësi publike ta trajtojë këtë çështje dhe duhet të marrë masa për këtë regjim në krejt botën.

Një tjetër çështje për diskutim ishte ndryshimi i regjimit të votimit duke

prezantuar një regjim tranzitor që do të vlejë vetëm për rastin e zgjedhjeve dhe do të jetë një shmangie nga parimi një anëtar një votë. Ky ndryshim propozohet me qëllim të rritet interesi i anëtarëve të rinj në IOSCO dhe të kenë hapësira për prezantim në strukturat vendimmarrëse dhe që diskutojnë politikën. Për këtë arsye propozohet që të ketë ndarje votash ndërmjet grupeve prej tre anëtarësh. Pavarësisht nga disa diskutime që pati mbi këtë regjim votimi dhe ndonjë problemi që mund të shkaktojë zbatimin e tij në praktikë, u theksua se është zgjidhja më e mirë që mund të ofrohet dhe do t'i propozohet Bordit për miratim.

Ideja e krijimit të Fondacionit të IOSCO me bazë në Spanjë, i cili ka qëllim që të sigurojë fonde për të financuar aktivitete në tre fusha: asistencë teknike për zbatimin e parimeve të IOSCO, trajnim dhe kërkim për çështjen që lidhen me tregun e titujve, u prezantua si veprimtari prej të cilave synimi është të përfitojnë vendet anëtare të IOSCO, veçanërisht ato me tregje në zhvillim.

Në përfundim në lidhje me zhvillimet në tregjet e çdo vendi për rastin e Shqipërisë u dhanë informacione mbi gjendjen e përgjithshme ekonomike në vend, vështirësitë në financim sidomos me ngërçin që ka pësuar kreditimit dhe pamundësinë e tregut të kapitaleve për të shërbyer si kanal financimi për ekonominë krahas atij bankar. U theksua që fokusi ynë për momentin është në forcimin e kapacitetit mbikëqyrës për fondet e pensionit dhe ndërtimin e kapaciteteve për çështje të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e diktuar dhe nga procesi i integritetit në BE.

---

Si rrjedhojë e krizës financiare botërore, pritshmëritë janë që tregu i titujve të luajë një rol shumë më të madh sesa deri më sot për financimin e ekonomisë në tërësi.

---

## Trajnim i mëtejshëm për aktuarët shqiptarë me metodikat dhe eksperiencat më të mira në Mbretërinë e Bashkuar

Programi i Zhvillimit të Sektorit Financiar (FSVC) në bashkëpunim me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve të Mbretërisë së Bashkuar, zhvilluan gjatë periudhës 22-29 shtator 2012 në Londër, Angli, trajnimin një javor për aktuarët e kualifikuar në maj të vitit 2011 dhe licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), të cilët kryesisht janë të punësuar në shoqëritë e sigurimit të Jetës, të Jo-Jetës si dhe në AMF. Trajnimi u zhvillua si vazhdimësi e mbështetjes për zhvillimin e profesionit të aktuarit në Shqipëri.

Gjatë javës u zhvilluan shumë takime me përfaqësues të shoqërive siguruese, risiguruese, ndërmjetësve në sigurime, institucione mbikëqyrëse, si dhe Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve në Londër dhe Oxford. Gjatë takimeve u diskutua lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e këtij profesioni në Mbretërinë e Bashkuar, situata aktuale si dhe mundësitë e zhvillimit të këtij profesioni në Shqipëri, si dhe u realizua: Përzgjedhja e shoqërisë Swiss Re si shoqëria më e madhe risiguruese në tregun e sigurimeve; Përzgjedhja e Lloyd's si Institucioni Unik i sigurimit në Mbretërinë e Bashkuar dhe në botë; Përzgjedhja e KPMG, Londër për të prezantuar funksionet e aktuarëve në një shoqëri audituese; Përzgjedhja e Unionit Kombëtar të Fermerëve, Stratford për shumëllojshmërinë e produkteve që ofron për tregun e sigurimeve, si dhe Përzgjedhja e CASS - Shkollë Biznesi në Londër si institucioni akademik i zhvillimit të profesionit të aktuarit.

Ndër temat e trajtuara në seminar, ishin: Çështjet aktuariale, si metodat e përdorura në llogaritjen e rezervave

teknike, trajtimin e dëmeve motorike tek produktet e sigurimit të Jo-Jetës, dëmet e shkaktuara nga katastrofat natyrore, produktet e sigurimit të Jetës, si dhe çështje të ndryshme që lidhen me funksionin e aktuarit; Çështje lidhur me tregun e sigurimeve në Shqipëri, të cilat momentalisht nuk kanë gjetur zgjidhje; Procesi i marrjes në sigurim, kryesisht për sigurimin e përgjithshëm, si dhe mbulimin ndaj dëmeve natyrore (katastrofat, etj), skemat e ndjekura prej tyre, si dhe trajtimin të dëmeve; Procesi i marrjes në sigurim mbi, përcaktimin e riskut, vlerësimin e kapitalit të shoqërisë, si dhe mbi ekspozimin ndaj rreziqeve të katastrofave natyrore; Roli i aktuarit, si dhe u trajtuan çështjet ku një aktuar duhet të fokusohet më së tepërmi gjatë punës së tij, si dhe diskutimi mbi llojet e produkteve që ofronin teknika të përgjithshme të marrjes në risigurim si dhe rëndësinë e lidhjes së kontratave me shoqëri risiguruese.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe rolit të shoqatës së Aktuarëve në Shqipëri, ku u diskutua për mundësitë e një bashkëpunimi të mundshëm me Shoqata të ndryshme në të njëjtat nivele të Shoqatës së Aktuarëve në Shqipëri.

Angazhimi i aktuarëve në këtë program trajnimi ishte në caktimin e një model vlerësimi të kapitalit, kryesisht për shoqëritë që operojnë në tregje më pak të zhvilluara të sigurimeve.

Takimet e mbajtura gjatë javës patën rëndësi në njohjen e metodikave të përdorura nga aktuarët lidhur me vlerësimin e primit, metodologjitë e përdorura për llogaritjen e rezervave

Trajnimi u zhvillua si vazhdimësi e mbështetjes për zhvillimin e profesionit të aktuarit në Shqipëri

teknike duke përfshirë si koeficient të rëndësishëm inflacionin, veçanërisht në llogaritjen e dëmeve shëndetësore, sinjalet paralajmëruese të situatave kritike (me nivel të lartë risku)

gjatë punës së aktuarit, njohjen me mundësitë e zhvillimit të këtij profesioni si dhe rëndësisë që i duhet të jepet Shoqatës së Aktuarëve në Shqipëri.

## TË REJA NGA RAJONI

### Të dhënat për gjashtëmujorin e parë, 2012

#### **Bullgari: Ulje të primeve të shkruara bruto në gjashtëmujorin e parë**

Të dhënat e fundit të publikuara nga Komiteti i Mbikëqyrjes Financiare Bullgare tregojnë që primet e shkruara bruto të realizuara nga siguresit bullgarë, arritën në shumën prej 796 milion BGN (407 milion Euro), duke patur një rënie prej 2.5% në bazën vjetore. Në fund të gjashtëmujorit të parë 2011, i njëjti tregues arriti vlerën prej 417.6 milion Euro, ndërkohë që tregu u rrit me gati 1% (0.8%).

Në fund të qershorit 2012, sigurimet e përgjithshme arritën në vlerën 666 milion BGN (341 milion Euro), duke shënuar një ulje prej 3%. Në të njëjtën kohë, primet e shkruara bruto për sigurimin e Jetës arritën në vlerën prej 130 milion BGN (66.2 milion Euro), duke patur një ulje prej 01.%.

Pjesa e sigurimit të Jetës, është një nga treguesit që pasqyrojnë zhvillimin e tregut të sigurimeve në tërësi. Në vendet e zhvilluara, format e sigurimit të Jetës përbejnë më shumë se 50% të biznesit të sigurimit të përgjithshëm. Në Bullgari, tregu i sigurimeve është i dominuar nga sigurimi i Jo-Jetës, ku pjesa e tregut në gjysmën e parë të 2012 pati një ulje prej 83.7%, krahasuar me 84.1% në fund të qershorit 2011.

Sigurimi motorik është linja më e rëndësishme e këtij tregu, me një pjesë prej 59%. Të ardhurat e përealizuara nga primi i sigurimit motorik në

Bullgari, arriti në shumën prej 470 milion BGN (240 Euro), krahasuar me 492 milion BGN, që arriti në gjysmën e parë të vitit 2011. Kjo rënie mund të shpjegohet në gjashtëmujorin pasues në të cilin një rënie pati në sigurimin Kasko. Në të ardhurat nga primet u raportuan: në janar-qershor 2012, primet e shkruara bruto nga sigurimi kasko arriti shumën 208 milion BGN (106.5 milion Euro), me një ulje prej 6% të regjistruar, krahasuar me rënie prej 12% të gjashtëmujorit të parë 2011 kundrejt gjashtëmujorit të parë të 2010. Në të njëjtën kohë, primet e shkruara bruto nga MTPL patën një ulje prej 3.4% krahasuar me 2010 dhe arriti një shumë prej 261 milion BGN (133.5 milion Euro). Një klasë tjetër e rëndësishme në tregun Bullgar është dhe sigurimi i pronës (zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë) i cili përmban 15% të tregut të sigurimeve.

Dëmet e paguara për sigurimin e Jo-Jetës arritën vlerën prej 330 milion BGN (169 milion Euro), duke shënuar një rritje prej 3.7% në bazën vjetore. Gjithashtu, trembëdhjetë kompani sigurimi (nga 18 që janë aktive) shënuan një rritje për këtë tregues. Në strukturën e kompensimeve të paguara nga klasat e sigurimeve, pjesën më të madhe e mbajti MTPL me 38.6%, pasuar nga sigurimi kasko me 35.2% dhe sigurimi i pronës me 8.8%.

## Slloveni: Tregu i sigurimeve vazhdon të ngadalësohet

Sipas të dhënave financiare të kohëve të fundit botuar nga Shoqata e Sigurimeve të Sllovenisë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 kompanitë e sigurimit sllovene regjistruan 1.094 milionë Euro primeve të shkruara bruto, nga të cilat 801.6 milionë Euro ose 73,26% nga kontratat sigurimit të Jo-Jetës dhe 292.5 milionë euro ose 26,74% nga sigurimet e Jetës.

Vëllimi i kompanive të sigurimit, përsa i përket marrjes në sigurim, është ulur me 3.7% (ose 42.5 milionë Euro në vlerë absolute) në krahasim me gjashtëmujorin e parë 2011, por sipas SIA, shifrat mund të jenë ndikuar dhe nga ndryshimet e rëndësishme në statusit të anëtarëve: KAD dhe SIA kanë ikur, ndërsa Modra i është bashkuar shoqatës.

Në gjashtëmujorin e parë 2012 marrja në sigurim ka rënë edhe në sigurimin e Jo-Jetës dhe në sigurimin e Jetës. Krahasuar me periudhën janar-qershor

2011, primet e shkruara bruto ka rënë me 0.74% në segmentin e Jo-Jetës dhe me 11,11% në sigurimin e Jetës.

Krahasimi i primit të shkruar bruto i mbledhur nga klasat e sigurimeve të Jo-Jetës tregon se 82.4% e primeve të Jo-Jetës janë mbledhur vetëm nga pesë klasat e sigurimit. Këto janë: TPL Slloveni, 1H2012. Tregu i sigurimeve vazhdon të ngadalësohet (19.2%), Kasko (17.4%), Dëmtime të tjera në pronë (sigurimet 9.6%), Zjarri dhe forcat e tjera të natyrës (8.5%), dhe Sigurim i Shëndetit (27.8%).

Në segmentin e sigurimit të Jetës ka pasur një rritje të vogël përsa i përket sigurimit tradicional të jetës (me 4.3%). Në të njëjtën kohë, primet e shkruar bruto të “Sigurimeve të lidhura me fonde investimi” është ulur me 18.2% në krahasim me vitin e kaluar, duke përfaqësuar 58% të totalit të segmentit Jetës.

## Maqedoni: Primet Bruto të sigurimit pësojnë rritje

Sipas të dhënave nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni, shoqëritë e sigurimit të Maqedonisë arritën një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 1.71 billion MKD (27.7 million Euro) në gjysmën e parë të vitit 2012 duke shënuar një rritje krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 kur kjo vlerë ishte 1.59 billion MKD. Primet në sigurimet e Jo-Jetës zinin 93.5% të totalit të primve të sigurimit.

Përsa i takon pagesave të dëmeve, gjatë periudhës janar-mars 2012, sigurimi motorik ishte mbizotërues me një total të dëmeve të paguara me 71.5%

(504 million MKD nga 705 million MKD), nga të cilat 51.7% ishin nga MTPL dhe 19.7% nga sigurimi vullnetar motorik. Me tej renditen sigurimi i aksidenteve me 12.6% dhe sigurimi i pronës me 11.6% të totalit.

Gjatë gjysmës së parë të 2012, shoqëritë e sigurimit regjistruan 196,022 kontrata sigurimi me një rritje krahasuar me vitin e kaluar kur kjo shifër ishte vetëm 185,009. Nga këto kontrata 1,321 ishin kontrata për produktet të sigurimit të Jetës dhe 194,701 ishin për sigurimin e Jo-Jetës. (Nga këto 116,421 ishin kontrata MTPL).

### Për këtë numër punuan:

*R. Guri, D. Kalaja, T. Baleta, I. Malile, V. Theodhori, F. Musta, A. Dervishi, F. Hebovija, E. Valera, P. Berberi, R. Eltari, E. Kokona*

Përsa i takon pagesave të dëmeve, gjatë periudhës janar-mars 2012, sigurimi motorik ishte mbizotërues me një total të dëmeve të paguara me 71.5%